



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primiheq/Prodato Received/Delivery	01.09.2023	3	Viti Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	5928/2023		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.910/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional; si procesmbajtëse, sipas ankesës me numër A.nr.910/2023, të datës 05.07.2023, të parashtruar nga ankuesja _____, kundër Aktvendimit me nr.03-3-065/202, të datës 06.06.2023 të Kryetarit të Komunës së Ranillugut, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 31.08.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.910/2023, e datës 05.07.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Anulohet Aktvendimi me numër protokoli 03-3-065/2023, i datës 06.06.2023, i Kryetarit të Komunës së Ranillugut.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Ranillugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta kthejë ankuesen në pozitën e punës Zyrtare për kadastër dhe gjeodezi, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagës, nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Komunën e Ranillugut, më datë 05.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.910/2023, kundër Aktvendimit me numër protokollit 03-3-065/2023, të datës 06.06.2023, të Kryetarit të Komunës së Ranillugut, pemës të cilit vendim ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Ranillugit, ndërsa, kjo e fundit, me datë 07.07.2023, ka përcjell shkresat referuar çështjes në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5016/2023, të datës 05.07.2023, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimi me numër protokollit 03-3-065/2023 të datës 06.06.2023, të Kryetarit të Komunës së Ranillugut; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit ; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 07.07.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës të datës 07.07.2023; Lista e ardhje-vajtje në punë e datës 04.05.2023; 03.05.2023; 02.05.2023; 10.02.2023; 16.02.2023; 15.02.2023; 14.02.2023; 13.02.2023; Akt Emërimi me Nr.prot.01-223/2016 të datës 12.04.2016; Listat e ardhje-vajtje në punë e datës e datës 15.05.2023; 12.05.2023; 11.05.2023; 10.05.2023; 05.05.2023; 25.05.2023; 24.05.2023; 23.05.2023; 22.05.2023; 19.05.2023; 18.05.2023; 17.05.2023; 16.05.2023; 26.05.2023; 29.05.2023; 30.05.2023; 31.05.2023; 20.02.2023; Njoftim për shkelje disiplinore me numër protokollit 03-3-021/2023, i datës 20.02.2023, nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi; Propozimi për shqiptimin e masës disiplinore me numër protokollit 03-1-088/2023 nga Komisioni Disiplinor; Procesverbali i Komisionit Disiplinor me nr.03-1-085/2023 i datës 15.03.2023; Vendimi me numër protokollit 01-144/2022 i datës 21.03.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor në Komunën e Ranillugut, Aktvendimi me Nr. protokollit 03-3-044/2023 i datës 28.03.2023 për shqiptimin e masës disiplinore i lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Rranillugut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat e marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, **SEPSE:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave materiale ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Komunën e Ranillugut dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 01-223/2016, të datës 12.04.2016, është emëruar në pozitën e punës me titull "*Zyrtare për Kadastër dhe Gjeodezi*".

Me tej nga shkresat e çështjes rezulton se më datë 20.02.2023, Drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Ranillugut, ka paraqitur të Komisioni Disiplinor kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankesës, më arsyetimin së e njëjta në vazhdimësi nuk ka ardhur në punë dhe nuk ka arsyetuar mungesat e saj, përkatësisht ankuesja nuk ka qenë në punë për periudhën: 10.02.2023, 13.02.2023, 14.02.2023 dhe 16.02.2023.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Ranillugut, më datë 17.03.2023, ka nxjerrë Propozimin me numër protokolli 03-1-88/2023, duke udhëzuar Drejtorin për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, që të nxjerr aktvendim për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankueses "ndalim 20% të pagës në afat prej tre muajsh", ndërsa, ky i fundit me Aktvendimin me numër protokolli 03-3-3-044/2023, të datës 28.03.2023, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Reduktimi i pagës në shumën prej 20% për një periudhë tremujore". Tutje, bazuar në vlerësimin e provave materiale të pashtuara nga palët në procedurë, del së Kryetari i Komunës së Ranillugut, me Aktvendimin me numër protokolli 03-3-065/2023, të datës 06.06.2023, ka ndërpre marrëdhënien e punës së ankueses, duke filluar nga data 05.06.2023, me arsyetimin se e njëjta, përkundër masës disiplinore të shqiptuar për mungesë të pajustificuar në punë, për periudhat paraprake, e njëjta serish ka vazhduar me mungesë në punë, gjithsejtë 24 ditë pune.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 59, më të cilin përcaktohet se: *Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon, si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji; 1.2. me lirim nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton së shqiptimi i masës disiplinore " lirim nga shërbimi civil" e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil në shërbimin civil, me kusht që të jenë respektuar në plotëni dispozitat ligjore sipas kapitulli IV, nënkapitulli 1, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje lidhur me ketë çështje administrative, mori parasysh edhe dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën dhe përgjegjinë disiplinore si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përkatësisht, bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji rithekson faktin së masat disiplinore që mund të shqiptohen ndaj nëpunësve civilë janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; dhe 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërsa sipas nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të të njëjtit ligj është përcaktuar se: *" Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. ...3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor...".* Ndërsa, me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: *"1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligji. 3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit.* Rrjedhimisht, sipas kësaj baze ligjore rezulton së Komisioni Disiplinor është organ i vetëm kompetent për shqyrtimin e shkeljeve të rënda disiplinore dhe shqiptimin masave disiplinore si: ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; dhe largimi nga Shërbimi Civil. Ndërsa, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i

nëpunësit civil është kompetente vetëm për shkelje të lehta disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore vërejtje.

Referuar përcaktimit ligjor dhe konstatimeve si me sipër, Kolegji konstaton së përkundër faktit së vendimi i ankimuar përkatësisht vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses bazohej në dispozitat e nenit 59, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i njëjti është nxjerrë në kundërshtim të plotë me këto dispozita ligjore, sepse, në rastin konkret, vendimi i atakuar më ankesë ishte nxjerr drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës së Ranillugut, pa ndonjë vendim të Komisionit Disiplinor për shqiptim të masës disiplinore "lirim nga Shërbimi Civil" dhe mbi bazë të të cilit është vetëtuar përgjegjësia disiplinore e ankueses së e njëjta ka kryer shkelje të rëndë disiplinore.

Për me tepër, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor i Komunës së Ranillugut, me datë 17.03.2023, kishte nxjerrë Propozim me numër protokolli 03-1-88/2023, duke udhëzuar Drejtorin për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, që të shqiptoj ndaj ankueses masën disiplinore "ndalim 20% të pagës në afat prej tre muajsh", me arsyetimin së ankuesja kishte munguar pa autorizim në punë për datat: 10.02.2023; 13.02.2023; 14.03.2023 dhe 16.03.2023, ndërsa, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, në Komunën e Ranillugut, në zbatim të propozimit të Komisionit Disiplinor, me Aktvendimin me numër protokolli 03-3-3-044/2023, të datës 28.03.2023, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Reduktimi i pagës në shumën prej 20% për një periudhë tremujore", veprime këto që në vlerësimin e Kolegjit janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse, siç u konstatua më lartë, mbikëqyrësi i ankueses mund të shqiptonte vetëm masën disiplinore "vërejtje" dhe atë pas vlerësimit së ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore, ose Komisioni Disiplinor, në rast të konstatimit së ankuesja ka bërë shkelje të rëndë disiplinor mund të shqiptonte drejtpërdrejt masën disiplinore " ndalim 20% të pagës në afat prej tre muajsh" , e jo të propozonte që masa disiplinore në fjalë të shqiptohej nga Drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses, kështu që, sipas Kolegjit të Këshillit edhe Aktvendimi me numër protokolli 03-3-3-044/2023, i datës 28.03.2023, i Drejtorit për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi, nuk përben bazë ligjore për ndërprerje të marrëdhënies së punës së ankueses, sepse aktvendimi në fjalë është nxjerr nga organi jo kompetent dhe se masa disiplinore e shqiptuar me këtë akt, nuk ka të bëjë me lirim nga shërbimi civil.

Nisur nga konstatimi së vendimi i ankimor është nxjerr me shkelje procedurale, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se Aktvendimi me numër protokolli 03-3-065/2023, i datës 06.06.2023, i Kryetarit të Komunës së Ranillugut, është akt juridikisht i pavlefshëm, andaj në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji aprovoj ankesën e ankueses si të bazuar, anuloi Aktvendimin me numër protokolli 03-3-065/2023, të datës 06.06.2023, të Kryetarit të Komunës së Ranillugut dhe obligoj këtë të fundit që ta kthejë ankuesen në pozitën e punës, Zyrtare për kadastër dhe gjeodezi, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe të bëjë kompensimin e pagës, nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.910/2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI,

Ardita Haxhnikaj

Krytare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Ranillugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ranillugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.